

Kërkesat e Parlamentit Studentor të UPZ-së:

1. Shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të emëruar nga MASHT-i për shkak të dështimit të përmbushjes së obligimeve të tyre karshi Universitetit të Prizrenit, duke shkelur Ligjin mbi Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit të Prizrenit dhe të gjitha rregulloret tjera.
2. Kërkojmë që Këshilli Drejtues i ri, të emërojë sa më shpejt që është e mundshme Ushtuesin e Detyrës së Rektorit, në përputhje me Statutin e Universitetit “Ukshin Hoti” dhe vendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, dhe në të njëjtën kohë ta shpall konkursin për rektor të rregullt pasi nga mungesa e rektorit më së shumti pëson Universitetit në përgjithësi e studentët në veçanti.
3. Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës dhe MASHT-i që studentëve të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren t’iu sigurohen bursa dinjitoze e jo ndihma sociale siç edhe ka ndodhur duke i ndarë për studentët elitë të Universitetit të gjeneratës 2014 vetëm nga 202.00 Euro.
4. Kërkojmë që si Universitet të jemi vijë buxhetore e veçantë dhe të gëzojmë autonomi financiare, për shkak të menaxhimit shumë më të mire të Universitetit dhe në mënyrë që studenteve tu mundësohen salla më të mira mësimi, laboratore moderne, stimulim për punët praktike e shumë të tjera.
5. Kërkojmë nga partitë politike që menjëherë të heqin dorë nga tentimi për të politizuar arsimin e lartë në Kosovë pasi që çdo tendencë e tyre do të has në kundërshtimin e studentëve.

I dërgohet:

Ministrit dhe MASHT-it,
Komisionit për vlerësimin e konfliktit të interesit në UPZ.
IP në Prizren dhe
Arkives.